



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 184, datë 30.3.2022

P Ë R

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.202, DATË 5.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NDËRTIMIN DHE RIKONSTRUKSIONIN E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, SI DHE ÇDO NDËRHYRJE TJETËR NË FUNKSION TË RINDËRTIMIT TË KËTYRE BANESAVE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pas pikës 2.2, të vendimit nr.202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2.3, me këtë përmbajtje:

"2.3. Fondi që do të përdoret, i miratuar në buxhetin e vitit 2022, do të jetë në masën 476 247 021 (katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë e dyqind e dyzet e shtatë mijë e njëzet e një) lekë pa TVSH, i cili do t'i shtohet Fondit Shqiptar të Zhvillimit në buxhetin e miratuar për vitin 2022, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit 06210 "Programe zhvillimi", për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, në

funkcion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.”.

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

## **K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ARBEN AHMETAJ**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN  
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

**ARBEN AHMETAJ**

NR.PROT. 1712/1  
DATË 30.3.2022

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR I  
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E  
REFORMAVE ✓  
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË  
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**

